



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 06.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **03.11.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **DEMOS SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ritender - Furnizim me Autoambulanca për nevoja të MSh-së”** me Nr. të Prok: **206-23-11548-1-1-1** nxjerr:

V E N D I M

1. **PRANOHET**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **DEMOS SH.P.K.** e dt. 03.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Ritender - Furnizim me Autoambulanca për nevoja të MSh-së”** me Nr. të Prok: **206-23-11548-1-1-1** kundër Njoftimit për Kontratë të datës 20.10.2023.
2. Plotësohet Njoftimi për Kontratë i datës 20.10.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **DEMOS SH.P.K.** me date 03.11.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ritender - Furnizim me Autoambulanca për nevoja të MSh-së”** me Nr. të Prok: **206-23-11548-1-1-1**. AK-MSh, me datë 06.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Nuk ka të specifikuar dispozita të shkelura nga AK.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Tek aktiviteti i prokurimit : Furnizim me autoambulanca Ritender duke marrë parasysh tregun e automjeteve që nga pandemia Covid dhe luftërat e ndryshme neper bote Bota ka ndryshuar shume me vonesa te shumta,Po kerkojme me miresi nga AK-ja juaj te lejoni dorezimin e veturave te parapare per

dorezim 2023-7 cope te jene edhe te prodhimit 2022 me km 00 per arsye se automjetet lejhen te pranohen si te reja me km 00 ne cdo shtet edhe te vitit paraprak.
JU lutem na tregoni se a lejohet dorezimi si me larte?

Dëmet materiale

Nuk ka te specifikuar dëme materiale.

Përgjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Sa i përket pretendimit tuaj ankimor, u lejohet furnizimi i 7 autoambulancave ne vitin 2023 qe janë te prodhimit 2022 me km 00. E njëjta vlen edhe për vitet tjera gjate implementimit te kontratës, ku lejohet furnizimi me autoambulanca te vitit paraprak me km 00, me kusht qe te jene te gjeneratës (serisë) së njëjtë me automjetet e ofertuara, ose gjeneratë me e re.

Ne si AK, duke marre parasysh rëndësinë e projektit dhe afatin e shkurtuar te tenderimit, e kemi marre mundin qe ta sqarojmë këtë Kërkesë për Rishqyrtim, edhe pse ju si OE është dashtë qe te beni pyetje sqaruese ne afatet e parapara ne NJK dhe ne DT dhe ne do u përgjigjeshim me sqarime shtesë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit